

---

# MËSOJMË GJATË GJITHË JETËS!

---

Efektet e trajnimeve për fuqizimin e kapaciteteve të edukatoreve në Institucionet Parashkollore në ofrim të programeve të edukimit në fëmijërinë e hershme

Salihe Gajtani-Osmankaq

Prishtinë, tetor – Ata i përkisnin grup-moshës 3 deri në 4 vjeç, por kishin përgjigje në të gjitha pyetjet e edukatores. I kishin mësuar ato përgjatë muajve dhe i thoshin pa drojë, sepse edukatore Irma kishte filluar të bashkëbisedonte me ta edhe më shumë se zakonisht. Për këtë, ajo dhe kolegja e saj Arlinda e kishin diskutuar rishtazi, përgjatë trajnimeve që kishin ndjekur në Fakultetin e Edukimit bashkë me një grup të edukatoreve që punojnë nëpër Institucionet Parashkollore (IP) në Kosovë.



Ato për shumë javë (ditëve të vikendit) kanë përcjell Modulet e trajnimeve për ofrimin e shërbimeve të integruara në fëmijërinë e hershme, të organizuara nga Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës, në kuadër të projektit të mbështetur nga UNICEF-i, në Kosovë. E veçanta e këtyre trajnimeve ishte ideja e përfshirjes së edukatorëve në shërbim jo vetëm nga kopshtet publike por edhe ato private. Në Kosovë, numri i kopshteve private tejkalon atë të kopshteve publike, duke ndikuar që edhe një numër i madh i fëmijëve, posaqerisht moshat 0-4 vjeç, të jenë të regjistruar në kopshte private.

Megjithatë, zhvillimi profesional i vazhdueshëm si një element i zhvillimit të cilësisë në edukimin në fëmijërinë e hershme, deri më tani ishte më tepër i fokusuar te kopshtet publike.

Përsosja e shakhtësive të zhvilluara në këto trajnime po rezultojnë të jenë mbresëlënëse përgjatë zbatimit në praktikë nga ana e edukatoreve.

Këtë e thotë edhe Irma Mujedini, e cila, prej më shumë se gjashtë vitesh punon në Institucionin privat parashkollor "Bardha Academy", në Prishtinë.



*"Bisedën me fëmijët për gjithçka që na rrethon, si metodë shumë efektive të punës me fëmijët e kemi praktikuar gjatë trajnimeve të fundit. Dhe kjo na ka ndihmuar shumë, sepse po e shohim se fëmijët e duan bashkëbisedimin",* thotë Irma.

Fëmijët, mezi prisnin t'i përgjigjeshin edukatores kur ajo u bënte pyetje. Shpesh bënin pyetje edhe vet fëmijët! Përgjigjet e tyre ishin mahnitëse, sa kreative po aq dhe imagjinate!

*"Çfarë na sjell vjeshta"* - pyeti edukatore Irma. *"Vjeshta na sjell frutat"* - u përgjigj një nga fëmijët. *"Në vjeshtë gjethet bien, e bari thahet"* - tha tjetri. *"E pse bien gjethet, apo thahet bari?"* - pyeste një



fëmijë tjetër. *"Sepse moti nis të ftohet"*, përgjigjej tjetri. Përgjigje, që ata mezi prisnin t'i thoshin. Por, që prisnin në radhë për ta thënë. Nëse shoku, apo shoqja e grupit veç kishte nisur të fliste, ata dëgjonin e prisnin radhën për të folur. E në radhë prisnin edhe derisa po bëheshin gati për të veshur xhaketat, sepse po dilnin në oborr për të luajtur.

*"Shikoni, edhe këtë metodë e kemi mësuar nga trajnimi. Sepse, para trajnimit gjithmonë të parët janë veshur, apo kanë folur, vetëm fëmijët që kanë qenë më të shkathët. Por, pastaj nga trajnimi ne kuptuam se fëmijët duhet të mësohen të presin në radhë. Ata duhet të mësohen të kenë durim dhe që të mos u jepet shansi që gjithmonë vetëm fëmijët më të shkathtë të jenë ata që të parët të dalin, flasin, apo zgjedhin lodrat"*, thotë Arlinda Veliu, një tjetër edukatore që punon së bashku me Irmen në të njëjtin institucion parashkollor.

Fëmijët dhe edukatorët nisin aktivitetet e ditës me një këngë, sapo të kenë pastruar duart pasi ata të kenë ngrënë mëngjes. Gjithnjë janë nën përcjelljen e edukatoreve, edhe gjatë ngrënies, e edhe kur pastrojnë duart. Ato duan të sigurohen që secili fëmijë ka ngrënë, secili ka pastruar duart dhe ka zënë pastaj një vend në dhomën e lojës.

Njëri pas tjetrit shkojnë dhe ulen në shiltet e bukura me plotë ngjyra. Në rrethin që e bënë, janë edhe të dy edukatorët. Aty, bashkë bisedojnë, në pyetjet dhe përgjigjet që i bëjnë dhe i japin njëri-tjetrit.

*"E kemi mësuar nga trajnimi që sa më shumë të bisedojmë më fëmijët, t'i motivojmë të përgjigjen, por edhe të bëjnë pyetje"*, thotë Arlinda. Ato të njëjtën gjë e bëjnë edhe kur dalin jashtë për të luajtur me fëmijët.

Irma ndërkaq, përmend një përvojë tjetër të re, që kanë mësuar nga trajnerët në Fakultetin e Edukimit.

Atë që fëmijët të mos detyrohen të bëjnë çdo gjë njësoj. Fëmijëve duhet t'u jepet mundësia për të zgjedhur aktivitetin që ata duan ta bëjnë dhe kanë interes, nevojë dhe potencial! Kjo sepse fëmijët janë të veçantë dhe rriten e zhvillohen sipas ritmit të tyre individual! Ne nuk synojmë të krijojmë shabllone të uniformuara por të zhvillojmë fëmijë të cilët kanë personalitetin e tyre të veçantë! Mundësia e zgjedhjes i bën ata të mendojnë për vendimet e veta dhe i bën ata më të përgjegjshëm!

Ajo thotë se para se të ndiqnin këto trajnime, kanë praktikuar që çdo fëmijët të bëjë pjesë aktive në secilën lojë, të përgjigjet në secilën pyetje apo të marrë pjesë në çdo aktivitet pa marr parasysh dëshirën apo interesin e tyre.

---

*“Tani, ne i lejojmë fëmijët që të zgjedhin nëse duan të marrin pjesë nëpër aktivitete të planifikuara. Ka fëmijë që ndonjëherë më shumë preferon njërin aktivitet, e tjetrin më pak. Dhe realisht kjo ndonjëherë na shtyn të mendojmë rreth zgjedhjeve të tyre. Shpesh herë, përmes kësaj metode, ne vërejmë edhe prirjet, apo talentet e fëmijëve”,* thekson edukatore Irma.

---





---

*“Është e bukur të shohësh, se ka fëmijë që janë të shkathtë në shumë aspekte. Ka disa të tjerë që kanë prirje të jenë liderë, ose menaxherë të mirë. I sheh tek u ndihmojnë shokëve të bëhen më të mirë, ose i ftojnë të luajnë bashkë ata shokë që hezitojnë të integrohen në lojë”, thotë edukatore Arlinda.*

---



Ajo vlerëson se nga shumë vjet përvojë pune në institucionet parashkollore, kjo ka qenë hera e parë për të që ka marrë pjesë në një trajnim që përfshinë sektorin publik dhe privat. Ajo dhe kolegja e saj thonë se trajnimet si këto që kanë ndjekur në Fakultetin e Edukimit, janë tepër të nevojshme dhe të dobishme, prandaj edhe bëjnë thirrje që këso trajnimesh të mbahen së paku një herë në vit.

Ajo thekson se janë të pafundme ditët kur ato ndihen të përmbushura në punë, sepse shohin fëmijë të lumtur, por edhe sepse në këtë disponim të tyre ndikon patjetër edhe mbështetja që edukatorët e marrin nga drejtuesit/drejtueset e institucionit.

E drejtoresha e “Bardha Akademy”, Gëzime Rexhepi- Çollaku thotë se kanë vërejtur se trajnimet kanë sjellë risi tek puna e edukatoreve.

*“Trajnimet janë gjithmonë të mirëseardhura, sepse po ndikojnë në forcimin e aspektit profesional të edukatoreve, e cila gjë pastaj po ndikon drejt për së drejti edhe në zhvillimin e fëmijëve në moshën e fëmijërisë së hershme. Do të dëshiroja të shihja çdo vit këso mundësi për trajnimin e edukatoreve”,* thotë drejtoresha Gëzime.

Ajo thekson se sa herë që do të ofrohen trajnime të këtilla, ajo do t’i dërgojë të marrin pjesë në to edukatorët që ajo i ka punësuar.

Zhvillimi profesional i vazhdueshëm i edukatorëve/eve është një domosdoshmëri e kohës e sidomos në një vend ku edukimi i hershëm është ballafaquar me shume sfida si mungesa e infrastrukturës dhe përshtatshmeria e saj për zbatim efektiv të programit, mungesa e politikave që rregullojnë teresisht edukimin e hershem, mungesa e kurrikules për tere grup-moshat 0-5 vjec, etj. Kete e deshmon jo vetëm vëzhgimi dhe intervista e realizuar me edukatorët pjesëmarrëse në trajnimet e fundit të implementuara

nga Fakulteti i Edukimit ne saje te mbeshtetjtes nga UNICEF-i ne Kosove por edhe prioritetet per Edukimin e Hershme ne kuader te Planit Strategjik te Arsimit në Kosovë 2022-2026."

Me shpresën se mbështetja e edukatorëve në punën me fëmijët e vegjël do të vazhdojë largohemi nga kopshti "Bardha" e në mëndje mbesin fytyrat e lumtura të fëmijëve që po kënaqeshin duke luajtur e duke mësuar përmes vetë-aktivitetit, eksplorimit, lëvizjeve, këngës, bashkëbisedimit, vrapimit, kërcimit, mu ashtu sic fëmijët kanë dëshirë! Mbi 300 eduaktorë në shërbim kanë përfunduar trajnimin 6 modular duke trajtuar tema të ndryshme, të rëndësishme për edukimin e hershëm si: të nxënit përmes lojës, zhvillimi i fëmijës, puna me projekte edukative, edukimi për vlera dhe barazia gjinor si dhe integrimi i teknologjisë në edukimin e hershëm. Projekti ka realizuar edhe disa aktivitete të tjera të cilat për synim kishin rrijten e cilësisë, avokimin dhe mbështetjet e drejtëpërdrejtë të studentëve, eduaktorëve dhe fëmijëve!